

VENDIM
Nr. 29, datë 22.2.2024

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 306, DATË 23.10.2023, “PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE SHOQËRISË ‘DRAGOBIA ENERGY’ SHPK, PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE FIKSE SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 575/1 prot., datë 15.2.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 306, datë 23.10.2023, për dhënie autorizimit nga ERE shoqërisë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollojnë intereset e saj”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 306, datë 23.10.2023 vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të Fikse (nëpërmjet hipotekimit), në favor të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., Bankës së Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a. (lista e asetëve bashkëlidhur).

2. Shoqëria duhet të dorëzojë kontratën finale të nënshkruar, ku të përfshihet vullneti i bankave (Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka e Tiranës sh.a. dhe Union Bank sh.a.) mbi gatishmërinë për të garantuar veprimtarinë e licencuar në rastin e kryerjes së transferimit, si pjesë përbërëse të saj.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin nëpërmjet hipotekimit të asetëve të paluajtshme të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta, në rast se do të ndodhi transferimi i këtyre asetëve nëse kjo kërkohet.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kudër të kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

- ERE, me shkresën nr. 2048/11 prot., datë 2.11.2023 njoftoi shoqërinë mbi vendimin e marrë nga Bordi, si dhe i solli në vëmendje depozitimin e dokumentacionit lënë kusht në vendim.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 575 prot., datë 5.2.2024 në kuadër të plotësimit të kushtit të lënë nga ERE, ka depozituar kontratën e kredisë bankare me nr. 6098 rep., nr. 2926 kol., datë 14.10.2023, si dhe akt marrëveshjen me nr. 6097 rep., nr. 2925 kol., datë 14.10.2023.

- Subjekti gjithashtu ka përcjellë deklaratën noteriale me nr. 644 rep., nr. 362 kol., datë 2.2.2024, të nënshkruar nga të tria bankat kredidhënëse (Banka Amerikane e Investimeve sha, Banka e Tiranës sha dhe Union Bank sh.a.), ku deklarohej se bankat kredidhënëse garantojnë angazhimin e plotë për vazhdimësinë e veprimtarisë së licencuar në rastin e kryerjes së transferimit të asetëve fikse të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve të rrjedhura nga kontrata e kredisë.

- Me depozitimin e dokumentacionit si më sipër cituar, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, si e tillë nuk gjen më zbatim as pika 4 e vendimit të Bordit nr. 306/2023, ndaj vlerësohet që pika 2 dhe 4 të shfuqizohen.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 306, datë 23.10.2023, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi